



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:033253

Datë: 09.11.2023

Numri i dokumentit: 04896187

P.nr.180/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarve: Xh. S. dhe A. S., për shkak se secili veç e veç ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.135/2021 datë 24.02.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më dt.08.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Besart Mustafa, si dhe të akuzuarve me mbrojtësit e tyre avokat B. S. dhe avokat R. P., në të njëjtën, mori publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 09.11.2023 këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

XH. S., nga i ati R. dhe nëna Z., e vajzërisë P., i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin S., Komuna e P., me numër personal të identifikimit:..., ka të kryer shkollën fillore, profesioni pensioner, i martuar baba i nëntë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

A. S., nga i ati Xh. dhe nëna Y., e vajzërisë S., i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin S., rruga "E. S.", Komuna e P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer fakultetin Shkenca Politike, profesioni Kordinator për Statistika, i martuar baba i një fëmiju, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

S e p s e,

I pandehuri Xh. S.

Me dt.11.02.2021, rreth orës 14:30^h, në fshatin S.-P., gjatë kontrollit nga ana e policisë të shtëpisë së të pandehurve, sipas urdhëresës për kontroll UGJK ..., është gjetur një armë zjarri-pushkë gjuetie dy tytëshe pa fishek, e tipit ..., modeli ..., me nr.serik ..., të cilën armë i pandehuri Xh. S. e ka mbajtur në pronësi, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

I pandehuri A. S.

I pandehuri, armën nga pika I e këtij dispozitivi të kësaj aktakuze, e ka mbajtur në posedim dhe kontroll, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, në atë mënyrë që, më të njëjtën armë ka dalur për gjueti dhe ka bërë fotografi, të cilat i ka postuar në rrjete sociale.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 366 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 322, 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452 të KPP-së, i:

G J Y K O N

- I. Të akuzuarin Xh. S. dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 500.00€ (pesëqind/euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.
- II. Të akuzuarin A. S. dënim me gjobë në shumë prej 250.00€ (dyqind e pesëdhjetë/€uro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri A. S. nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

Konform nenit 366 të KPRK-së, të akuzuarit A. S., i konfiskohet një armë zjarri-pushkë gjuetie dy tytëshe pa fishek, e tipit ..., modeli ..., me nr.serik ..., si mjet i kryerjes së veprës penale.

Gjykata e liron të akuzuarin Xh. S. nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Detyrohet i akuzuari A. S. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), gjithashtu në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ushtruar aktakuzën, PP/I.nr.135/2021 datë 24.02.2021, kundër të akuzuarve: Xh. S. dhe A. S., për shkak se secili veç e veç ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Lënda, P.nr.108/2023, me të gjitha shkresat e saj, me datë 21.03.2023, është dërguar në kompetencë territoriale nga Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, në Degën e Gjykatës në Podujevë.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 08.11.2023 gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i akuzuari Xh. S. me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokat B. S., si dhe i akuzuari A. S. me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokat R. P.

I akuzuari Xh. S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me veprën penale që i vihet në barrë deklaroi: E pranoj fajësinë, kam menduar se leja që e kam pasur ende është valide, për atë nuk kam shkuar për të vazhduar, jam pensioner i pleqërisë, i sëmur me terapi, armën e kam pasur për gjueti kujtim nga baba, me askënd nuk kemi probleme, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. S., avokat B. S. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: Meqenëse i mbrojturi im e pranoj fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet, gjykatës i propozoj që të aprovoj pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti pranim ka mbështetje në shkresat e lëndës.

I akuzuari A. S. në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me veprën penale që i vihet në barrë deklaroi: E pranoj fajësinë edhe pse fillimisht kam menduar se nuk kam kryer vepër penale, unë vetëm kam dashur të shëtisë me shoqëri, është hera e parë që jam në gjykatë, lus gjykatën që ti merr të gjitha rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë, pasi që jam i martuar, mbajtës i familjes prindin e kam të sëmurë me terapi.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. S., avokat R. P. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: Konsiderojmë se pranimi i fajësisë nga klienti im është bërë konform dispozitave ligjore, pasi që i njëjti ka kuptuar natyrën dhe peshën e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjykata konform nenit 322 par. 2 të KPP-së, ka dëgjuar prokurorin e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurve, pranimin e fajësisë e kanë bërë në mënyrë vullnetare, prandaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësve të akuzuarve, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 322 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 322 par.4 të KPP-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar deklaron: Pasi gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë, i propozoj gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. S., avokat B. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: I propozojmë gjykatës që me rastin e marrjes së dënimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimin e fajësisë, mos dijeninë e të mbrojturit tim se është dashur ti vazhdohet leja armës, gjendjen e tij shëndetësore, moshën e shtyrë, gjendjen ekonomike jo të mirë, po ashtu si rrethanë lehtësuese të merr faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar, andaj i propozojmë gjykatës që ndaj të mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. S., avokat R. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: I propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë të bërë nga klienti im ta marr si rrethanë lehtësuese posaçërisht lehtësuese, ashtu që ndaj të njëjtit ti shqiptoj një dënim sa më të butë në bazë të ligjit.

Të akuzuarit në fjalën përfundimtare të tyre janë pajtuar me deklaramentet e mbrojtësve të tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet të akuzuarit, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarve përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, për çka të njëjtit i shpalli fajtor dhe i'u shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se të akuzuarit në fillim të shqyrtimit gjyqësor e kanë pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burg, për të akuzuarin A. S. është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi konfiskimin e armës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të akuzuarin A. S., gjykata e ka marrë në bazë të nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale paushallit gjyqësor, për të akuzuarin A. S., u marr në bazë të nenit 449 lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale për të akuzuarin Xh. S., është marrë në kuptim të nenit 452 par. 4 KPP-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.180/2023 me dt.09.11.2023

G j y q t a r i

Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.